

## STATUT

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR

"Este Medical Group Tirana" Sh.p.k

Sot më datë , 24 / Dhjetor/ 2024 , në Rruga Kavajes, Pallati "Garden Building" , Kat i dyte, Apartamenti Nr.2B, Tiranë , është i pranishëm përsonalisht Ortaku:

Brixhilda Karaj , lindur ne Tirane, më 22.12.1996 , identifikuar me numer Personal J66222038V , madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Ortaku e shoqërisë në themelim deklaron me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë, pranimin e dispozitave dhe parashikimeve që vijojnë, hartimin e Statutit të shoqërisë së re të së drejtës shqiptare "Este Medical Group Tirana" Sh.p.k mbi bazën e ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar dhe hartojnë këtë Statut si vijon:

#### Neni 1 Emërtimi i Shoqërisë

Emri i shoqërisë është "Este Medical Group Tirana" Sh.p.k. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me emrin "Este Medical Group Tirana" Sh.p.k (në vijim "Shoqëria").

#### Neni 2 Selia

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga Kavajes, Pallati "Garden Building" , Kat i dyte, Apartamenti Nr.2B, Tiranë

Asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë, si dhe mund të vendosë hapjen e degëve dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 3 Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e Shoqërisë fillon nga momenti i regjistrimit të saj pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit dhe është pa afat të caktuar.

Shoqëria e fiton përsonalitetin juridik nga momenti regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) Tiranë.

#### Neni 4 Objekti i Shoqërisë

Shoqëria ka për objekt:

Klinike mjeksore dermatologjike, estetike dhe dentare.

#### Neni 5 Kapitali i Shoqërisë

**5.1** Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 100.000 (njëqindmije) Lekë . Kapitali themeltar është i përbërë nga 1 ( një ) kuotë e cila zotërohet nga Ortaku :

- **Brixhilda Karaj**, lindur ne Tirane, më 22.12.1996, identifikuar me numer Personal J66222038V, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Kapitali fillestare i Shoqërisë mund të rritet dhe është totalisht i paguar dhe nënshkruar nga ortakët.

**5.2** Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestare, nga pasuri të luajtshme ose të pa luajtshme dhe nga pasuri të tjera të dhëna ose që do të jepen të cilat janë të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë.

**5.3** Kuotat e kapitalit derdhen nga ortakët në Bankë, ne llogarine bankare të Shoqërisë dhe derdhjet e kuotave regjistrohen në librin e llogarisë së Shoqërisë.

**5.4** Të gjitha pjesët e kapita lit themeltar janë të nënshkruara nga ortakët e Shoqërisë.

**5.5** Ortakët kanë të drejtë të térheqin fondet e depozituara si kapital themeltar të Shoqërisë, ne rast se Shoqëria nuk regjistrohet ne Qëndrën Kombëtare të Biznesit, brenda 6 (gjashtë) muaj nga data e depozitimit të fondeve.

#### Neni 6 Transferimi i kuotave me akt midis të gjallëve dhe me trashëgimi

**6.1** Transferimi i kuotave është i vlefshëm si me akt midis të gjallëve si dhe me trashëgimi ndaj ortakëve të Shoqërisë, vetëm ne rast se rezulton se janë respektuar dispozitat e këtij neni.

**6.2** Në rast transferimi të kuotave midis të gjallëve me akt, ortakëve i takon e drejta e parablerjes. Ortaku transferues më parë duhet të bëjë një ofertë, ortakëve të tjerë me letër rekomande, ku përcakton cmimin e kërkuar për shitjen e kuotave të tij. Në ketë rast secili nga ortakët në proporcion me pjesëmarrjen në kapitalin themeltar ka të drejtën e parablerjes.

**6.3** Në rast mosmarrëveshjesh mbi cmimin e kërkuar, ky i fundit do të përcaktohet nga një eksperti kontabël i cili miratohet me shumicë të thjeshtë nga asambleja e ortakëve i cili do të përcaktoje cmimin e shitjes duke u bazuar mbi vlerën reale të kuotave.

**6.4** Në rast mosmarrëveshjeje mbi emërimin e ekspertit kontabël, ky i fundit me shpenzimet e secilës palë, do të zgjidhet nga gjykata ku ka selinë shoqëria dhe me kërkesë të palës së intëresuar.

**6.5** Eksperti duhet të kryejë vlerësimet sipas kritëreve dhe mënyrave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

**6.6** Pas vlerësimit të kuotave nga ana e ekspertit, shitësi por edhe blerësi kanë të drejtë të tërhiqen, përkatësisht nga shitja dhe blerja dhe shpenzimet e ekspertit do të janë në ngarkim të personit që tërhiqet.

**6.7** E drejta e parablerjes që nuk është ushtruar nga ana e njërit prej ortakëve i kalon ortakëve të tjera, gjithmonë në përputhje me pjesët e tyre në kapitalin themeltar.

**6.8** Ortaku shitës i kuotave duhet t'i transferojë këto të fundit me akt të shkruar ortakëve blerës brenda 3 muajve nga marrja e komunikimit dhe në rast të vlerësimit të bërë nga eksperti kontabël brenda afatit prej 60 ditë nga dita e vlerësimit.

**6.9** E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet brenda një periudhe tre mujore nga data e komunikimit të ofertës ose brenda 60 ditëve nga data e fiksimit të cmimit nga ana e ekspertit kontabël që është emëruar. Pasi kanë kaluar afatët e mësipërme, shitësi ka të drejtën t'i transferojë tëk të tretët kuotat e tij.

**6.10** Transferimi i kuotave për shkak trashëgimie ndaj trashëgimtarëve të të ndjerit është i kufizuar me dhënen e miratimit e ortakëve të mbledhur në asamblenë e përgjithshme. Në rast kundërshtimi të ortakëve për transferimin e kuotave drejt trashëgimtarëve të të ndjerit, cmimi i shitjes do të caktohet sipas procedurave për transferimin me akt midis të gjallëve si me sipër.

#### **Neni 7**

Fitimet e Shoqërisë i takojne ortakeve të saj. Asambleja sipas ligjit vendos për ndarjen ose ri qarkullimin e tyre, duke përcaktuar edhe mënyrat.

#### **Neni 8**

Shoqëria do të përdorë dhe disponojë pasurine e saj të akumuluar. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, matériale ose jo-matériale, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurisë së vet të akumuluar, tëk të tjerët.

Në Republikën e Shqipërisë, Shoqëria gezon të drejta sikundër cdo person tjeter juridik, shqiptar ose i huaj, sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 9**

Shoqëria, vepron në regjin e pronës privatë dhe merr përsipër të drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kapitalit të investuar ne të.

#### **Neni 10 Drejtimi i Shoqërisë**

Bëjnë pjesë në detyrat dhe kompetencat e ortakëve, të mbledhur në asamble të përgjithshme, të gjitha ato që janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe të listuara në këtë statut. Ndër këto detyra përfshihen:

1. ndryshimi në aktin e themelimit dhe ne statut;
2. miratimi i buxhetit vjetor, të veprimtarise së dministrimit, të inventarit, të bilancit të llogarisë vjetore;

3. emërimi e shkarkimi i administratorëve qofshin ortakë ose jo dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetëncave të tyre, duke përcaktuar se qoftë për emërimin ashtu edhe për shkarkimin nuk do të jetë e domosdoshme të jepet shprehimisht motivi;
4. miratimin e kredive dhe të garancive;
5. miratimi i tarifave për shërbimet qe kryen shoqëria;
6. përcaktimi i formës së vulës dhe të markës së shoqërisë;
7. zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë;
8. mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
9. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
10. vendimin lidhur me krijimin apo mbylljen e filialeve, përfaqësimeve ose të agjencive të Shoqërisë;
11. vendimin për riorganizimin dhe mbylljen e Shoqërisë;
12. vendimin për nisjen e një mosmarrëveshje ligjore apo për zgjidhjen e një mosmarrëveshje ligjore në të cilën është e përfshirë Shoqëria;
13. vendimin për emerimin dhe shkarkimin e likuidatoreve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar apo të konsulentëve të tjere, qoftë persona fizike qoftë juridike;
14. vendimin për ndarjen e kuotave dhe për anullimin tyre;
15. vendimin për miratimin dhe ndryshimin e rregullave të procedurës për mbledhjen e asamblesë;
16. vendimin për dhënien ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të Shoqërisë;
17. vendimin në shitjet e kuotave të Shoqërisë;
18. vendimin për cështje të tjera të parashikuara me ligj apo nga statuti;
19. marrjen e cdo vendimi tjetër që nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër.

#### Neni 11

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga administratori drejt ortakëve me shkresë ose sipas zgjedhjes së administratorit nëpërmjet postës elektronike. Adresa elektronike email e ortakëve regjistrohet në dokumentet e Shoqërisë.

Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e duhet t'u dërgohet të gjithëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas modalitetit të lartpërmendur, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë këto vendime, pavarësisht nga mungesa e njoftimit për thirrje.

#### Neni 12

Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim. Pjesëmarrja apo votimi në asamblënë e përgjithshme, mund të kryhet edhe nëpërmjet mjeteve elektronike. Në këto raste është e nevojshme prania e Noterit. Prosesverbal i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të shoqërisë nën kujdesin e administratorit.

Asambleja e përgjithshme mund të mblidhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast vendimet e asamblesë së përgjithshme të marra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do t'i nënshtrohen procedurave të parashikuara nga ligji shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Shqipëri.

Kuorumi i nevojshëm për të vendosur në asamblenë e zakonshme dhe/ose jashtëzakonshme është ai i parashikuar ne nenet 86, 87 të ligjit 9901 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

### Neni 13

Administratori i parë dhe i vetëm i shoqërisë është:

**Brixhilda Karaj**, lindur ne Tirane, më 22.12.1996, identifikuar me numer Personal J66222038V, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar., i cili ushton të gjitha veprimtaritë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Administratori i vetëm emërohet për një afat 5 (pesë) vjecar duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, me të drejtë riemërimi në qoftë se do të emërohet sërisht administrator nga asambleja e ortakëve.

Asambleja e përgjithshme mund të vendosë për shkarkimin e tij. Administratori ka të drejtë të japë dorëheqjen e parakohshme, përpara mbarimit të mandatit, me njoftim, dhënie llogarie dhe aprovim përpara asamblesë së përgjithshme, sipas procedurave të parashikuara me ligj.

Asambleja e përgjithshme mund të emërojë edhe më shumë se një administrator, të cfarëdo kombësie dhe të jashtëm për shoqërinë. Në rastin e emërimit të një apo më shumë administratorëve në fuqi, secili nga administratorët mund të ushtrojë të gjitha tagrat e përfaqësimit dhe të firmës ashtu si rezultojnë në aktin e emërimit të tyre. Secili nga ato do të jetë individualisht përgjegjës për përbushjen e funksioneve të dhëna nga ligji për administratorin dhe do t'i komunikojë të tjerëve ose administratorit tjetër veprimet nga ai të kryera. Administratori ose administratorët kanë detyrimin të jalin llogari përpara asamblesë së përgjithshme të ortakëve, për aktivitetin e tyre, cdo herë që i kërkohet nga ortakët.

### Neni 14

Administratori i vetëm kryen detyrat e përcaktuara nga ortaket e Shoqërisë ne ketë statut dhe të gjitha ato detyra të parashikuara dhe të rregulluara me ligj. Ndërkohë përshihen detyrat e listuara me poshtë.

1. Të veproje dhe të nënshkruaje ne emër të shoqërisë.
2. Të hartoje rregulloren e brendshme të shoqërisë dhe një plan biznesi për vitin financier, qe do të miratohet ne asamblenë e përgjithshme.
3. Të marre vendime lidhur me kreditë qe do të merren dhe dhënien e garancive.
4. Të përpunoje dhe të paraqesë për miratim ne asamblenë e përgjithshme raportë për ecurinë e aktivitetit të shoqërisë dhe të bilancit të mbylljes se aktivitetit financier të vitit paraardhës, sipas asaj që parashikohet në ligj.
5. Të mbajë në rregull regjistrin e vendimeve të asamblesë së përgjithshme.

6. Administratori (apo administratorët në rast se do të emërohet ndonjë tjetër në vijim) është përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe të tretëve për shkeljet e ligjit apo të normave të statutit që mund të ndodhin gjatë ecurisë se aktivitetit, sipas legjislacionit shqiptar.
7. Të kryeje të gjitha aktivitetet e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme.
8. Të përfaqësoje shoqërinë tregtare.
9. Të kujdeset për mbajtjen e dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë me korrekësi dhe saktësi.
10. Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet ne ligjin për Qëndrën Kombëtare të Biznesit.
11. Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
12. Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë.
13. Pranimet në punë, pagat, largimet nga puna, masat disiplinore për vartësit, miratimin e kërkesave për largim nga puna pasi të jetë marrë më parë aprovimi nga asambleja e ortakëve.
14. Të emërojë financier e konsulentë për problemet e shoqërisë. Financieri nxjerr rregullisht indikatorët financiarë tre-mujorë, gajshtë-mujorë dhe vjetorë, për aktivitetin e kryer të Shoqërisë.
15. Të mirë administrojë Shoqërinë.
16. Të lidhë marrëveshje me të tretë ne kufijtë e objektit të aktivitetit të Shoqërisë dhe të kompetencave të përcaktuara nga ortakët.
17. Të zbatojë rregulloren e brendshme të Shoqërisë.
18. Të jetë përgjegjës për dëmet e shkaktuara Shoqërisë nga veprimet e tij.
19. Të shpërblehet për punën që kryen sipas marrëveshjes me ortakët themelues.
20. Të informohet dhe të bëjë propozime për çfarëdolloj gjëje që e vlerëson si të rëndësishme për shoqërinë.
21. Të kryejë të gjitha veprimet bankare në lidhje me llogarinë e shoqërisë.
22. Administratori ka të drejtë dhe detyrë të thërrasë asamblenë e përgjithshme, sipas dispozitave të përcaktuara ne nenet 11 dhe 12 të këtij statuti dhe të ligjit aty ku nuk parashikohet shprehimisht në statut.

#### **Neni 15 Të drejtat e Shoqërisë**

Shoqëria ka të drejtë:

1. të kryejë veprimtari në baze të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë;
2. të sigurojë pasurinë e vet;
3. të marreë kredi në lekë dhe në valutë nga Bankat vendase ose të huaja në bazë të rregullave ligjore;
4. të përfitojë nga favoret që i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera;
5. të investojë kudo në Shqipëri, me të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj;
6. të punësojë punëtorë, vendas ose të huaj;
7. të eksportojë lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj.

#### **Neni 16 Detyrat e Shoqërisë**

Shoqëria ka për detyrë:

1. të sigurojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohën e duhur;
2. të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria;

3. të sigurojë punonjësit e saj;
4. të plotësoje detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo;
5. të pajiset me leje/autorizime të mundshme, nëse kërkoen nga ligji, për të zbatuar objektin e veprimtarisë së saj;
6. të respektojë standartet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

#### **Neni 17 Marrëdhëniet ekonomike – financiare të Shoqërisë**

E gjithë veprimtaria e shoqërisë për plotësimin e objektit të veprimtarisë se saj, pasqyrohet në bilancin ekonomik të saj.

#### **Neni 18**

Në selinë e Shoqërisë mbahet dokumentacioni finansiar, në bazë të të cilit, brenda datës 31 mars të çdo viti nxirret bilanci vjetor i Shoqërisë.

#### **Neni 19**

Viti finansiar fillon çdo vit më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

#### **Neni 20**

Shoqëria mban llogarinë e saj në Bankë. Llogaritë mbahen në LEKE dhe/ose EURO dhe pasqyrohen në librat kontabël përkatës.

#### **Neni 21**

Nga fitimet e realizuara gjatë vitit finansiar, Shoqëria, pasi bën zbritjen e humbjeve të vitit të mëparshëm, le mënjanë 5% të fitimit, me të cilin krijohet fondi “Rezervë e domosdoshme”, derisa ky fond të arrijë masën 10% të kapitalit themeltar.

#### **Neni 22 Dispozita të vecanta**

Shoqëria ka vulën e saj me përmasa të zakonshme, të realizuar sipas parashikimeve të ligjit ne fuqi dhe mund të ketë një markë të vetën. Në rast të krijimit të një faqe interneti, mund të deklarohet në mënyrë vullnetare në QKB.

#### **Neni 23 Shndërrimi**

Shndërrimi i Shoqërisë në shoqëri të tipeve të tjera, mund të bëhet me vendim të ortakëve themelues sipas mënyrave të parashikuara në ligj.

#### **Neni 24 Prishja e Shoqërisë**

Shpërbërja e shoqërisë, mund të vijë për shkaqet e parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 dhe për arsyet si më poshtë:

- me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;

- me vendim të gjykatës;
- humbja e kapitalit të Shoqërisë;

Në këto raste, ortakët e shoqërisë vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose më shumë likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë se Shoqërisë deri sa ajo t'u dorëzohet personave përkatës fizikë e juridikë, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet që ka shoqëria ndaj personave të tretë.

Në rast se fondet e disponueshëm, rezultojnë të pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkojë ortakëve themelues të Shoqërisë që të derdhe tërësisht kuotat që u takojnë.

#### **Neni 25 Ligji i aplikueshëm dhe Juridiksioni**

Të gjitha konfliktet që mund të lindin midis ortakëve të Shoqërisë, midis ortakëve dhe Shoqërisë, midis Shoqërisë dhe Administratorit do t'i nënshtrohen për zgjidhje gjykatës kompetente të Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjet shqiptare ne fuqi.


#### **Neni 26**

Ky statut përpilohet ne 2 ( dy ) ekzemplarë në gjuhën shqipe , të nënshkruara rregullisht nga Ortaku.

Ngarkohet administartori **Brixhilda Karaj** , lindur ne Tirane, më **22.12.1996** , identifikuar me numer Personal **J66222038V** , për të kryer të gjitha procedurat pranë QKB-së për rregjistrimin e shoqërisë.

#### **ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË**

**Brixhilda Karaj**



*Tiranë më 24 /Dhjetor / 2024*